



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:165512

Datë: 17.09.2024

Numri i dokumentit: 06172271

Ac.nr.8776/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Naim Mehulli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “K.&A.”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-Spitali Rajonal në Prizren, për kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2663/2022, të datës 16.11.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 17.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e paditëses R.K. nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2663/2022, të datës 16.11.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses R.K. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që “të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës – Spitali Rajonal në Prizren, që paditëses, në emër të shpërblimit jubilar t’i paguaj një (1) pagë mujore neto, në shumën prej 625.27 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i paditëses në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar ankesën e të paditurës, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses sa i përket dy pagave jubilarë, ose të anuloj aktgjykimin ankimor dhe çështjen ta kthej në procedim të sërishëm.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, nëpërmes të autorizuarit, ka ushtruar padi kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës- Spitali Rajonal Prizren, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, t'ia kompensoj një pagë mujore në shumë prej 625.27 €, duke përfshirë kamatën ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë dhe shpenzimet e procedurës.

Nga ana tjetër e paditura me përgjigje në padi ka propozuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit për shkak të parashkrimit të kërkesës në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit paraprak të saj, vlerësimit të përgjigjes në padi të së paditurës, administrimit të provave si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, jashtë shqyrtimit gjyqësor, konform nenit 399 të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e tillë të vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, me çka drejtë ka ardhur edhe gjer te aplikimi i të drejtës materiale.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë, pasi që nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune të paditura që nga data 01.10.2008, fakt i vërtetuar me vërtetimin e datës 24.12.2020, mirëpo si çështje kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit lidhur me kompensimin e një page jubilarë, të cilën paditësja e pretendon me padi. Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes i është referuar dispozitës së nenit 90 par.4 të Ligjit të

Punës me të cilin është e përcaktuar se: *‘Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri(3) vjet’*. Ndërsa që Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë së Kosovës ka hyrë në fuqi nga data 12.06.2018 dhe ka pasur shtrirje kohore të zbatimit deri me datë 12.06.2021, andaj duke pas parasysh faktin se paditësja padinë e ka ushtruar me datë 15.08.2022, ndërsa që 10 vite të përvojës së punës I ka arritur me dt.15.05.2022, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në rastin konkret kërkesa e paditëses është parashtruar pas skadimit të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë.

Në këtë drejtim edhe Gjykata e Apelit e përkrah mendimin e gjykatës së shkallës së parë të dhënë në aktgjykimin e atakuar, se kërkesëpadia e paditëses është e pathemeltë, duke pas parasysh faktin se Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë së Kosovës ka filluar të zbatohet nga data 12.06.2018 me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite, përkatësisht deri me datën 10.06.2021, ndërsa që paditësja ka ushtruar padi me datë 15.08.2022, e njëjta është paraqitur pasi që ka pushuar së zbatuari kjo Kontratë. Këtë fakt e ka vërtetuar edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar mendimit juridik të saj (*mendimi juridik për shpërblim jubilar dt.27.02.2023, faqja 2, parag.V*), ku parashihet se: *‘Kontrata Kolektive Sektoriale e lidhur më datë 12.06.2018, dhe nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës), e datës 12.06.2018) aplikohet në periudhën kohore nga data 11.06.2018-10.06.2021’*.

Rrjedhimisht të drejtë kjo gjykatë e vlerëson përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë kur e njëjta me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses, në bazë të provave të administruara nuk ka dal e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet refuzuar, ngase edhe kjo gjykatë me shikim në shkresat e lëndës konstaton se paditësja nuk ka mundur ta provojë të drejtën e saj të pretenduar sa i përket themelësisë së kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8776/2022, me datë 17.09.2024

Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.